



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.79

2005

31 tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i ISSH nr.1/1, datë 8.2.2005	Për një ndryshim në udhëzimin nr.1, datë 24.12.2002 "Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni".....	2607
Udhëzim i ISSH nr.2, datë 5.10.2005	Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar e të pagës neto për efekt pensioni".....	2607
Rregullore e ISSH nr.34/2, datë 5.10.2005	Për disa shtesa e ndryshime në rregulloren nr.34, datë 1.2.2002 "Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve", e ndryshuar.....	2610
Rregullore e ISSH nr.38, datë 7.9.2005	Për kontributet e sigurimeve shoqërore".....	2611

UDHËZIM
Nr.1/1, datë 8.2.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 24.12.2002
“PËR LLOGARITJEN DHE INDEKSIMIN E BAZËS SË VLERËSUAR PËR EFEKT
PENSIONI”

Bazuar në nenin 74 dhe në nenin 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e tij të datës 8.2.2005, Këshilli Administrativ i ISSH-së, ndryshoi pikën 3 të udhëzimit nr.1, datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”:

1. “3. Për personat që periudhën e fundit të aktivitetit ekonomik, pas datës 1.1.1994, e kanë si të vetëpunësuar në bujqësi dhe plotësojnë kushtet për pension qyteti, sipas nenit 96 paragrafi 1, 2, 3, si dhe për ata që plotësojnë kushtet për pension fshati, sipas nenit 96 paragrafi 4, baza mesatare e vlerësuar do të llogaritet mbi pagat minimale të caktuara në vitin përkatës me vendime të Këshillit të Ministrave, indeksuar me koeficientët vjetorë si më sipër.”.

2. Ky ndryshim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Engjell Bejtaj

UDHËZIM
Nr.2, datë 5.10.2005

“PËR LLOGARITJEN DHE INDEKSIMIN E BAZËS SË VLERËSUAR E TË PAGËS NETO
PËR EFEKT PENSIONI”

Bazuar në nenin 74 dhe në nenin 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në mbledhjen e tij të datës 5.10.2005, Këshilli Administrativ i ISSH-së nxorri këtë udhëzim:

I. Për personat që e drejta për pension u ka lindur pas datës 15.6.2005, e në vazhdim, baza mesatare mujore e vlerësuar për efekt pensioni llogaritet si shumë e pagave për të cilat janë derdhur kontribute nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit me pagat referuese të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për të gjitha periudhat e njohura si periudha sigurimi para datës 31.12.1993, të indeksuara me koeficientët e miratuar çdo vit me vendime të Këshillit të Ministrave, pjesëtuar me periudhën e sigurimit së cilës i përgjigjen këto paga.

Pagat referuese janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficientët vjetorë të indeksimit të bazës së vlerësuar përcaktohen çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

II. Baza e vlerësuar për periudhat e njohura si periudha sigurimi sipas nenit 58 pika 1, shkronja “a”, nenit 91 pikat 1,2 dhe 3 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, (i ndryshuar), është si më poshtë:

1. Për periudhat e punësimit, të njohura si “vjetërsi pune” para datës 31.12.1993, baza e vlerësuar është shuma e pagave referuese sipas llojit të punës së kryer dhe arsimimit individual, të indeksuara, mbështetur në pagat e përcaktuara në pasqyrat A1, A2 dhe A3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 12.8.2005 “Për caktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”.

2. Për periudhat e punësimit, vetëpunësimit apo sigurimit vullnetar pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar është shuma e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet për periudhën ekonomiksht aktive, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

3.a) Për periudhën gjatë së cilës personi ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak para datës 1.1.1994, baza e vlerësuar është shuma e pagave referuese, e përcaktuar në tabelat A1, A2, A3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 12.8.2005 “Për caktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, të indeksuara me koeficientët sipas viteve. Në rastet kur para fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, personi nuk ka punuar, si pagë referuese merret paga e caktuar në tabelën A3, numri rendor 33 “punëtorë të tjerë”, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

3.b) Për periudhën gjatë së cilës personi ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar është shuma e pagave minimale për efekt të pagesës së kontributeve në muajt/vitin përkatës, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve. Në rastet kur para fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, personi ka punuar, baza e vlerësuar është paga mesatare mbi të cilën janë paguar kontribute në vitin e fundit të punës, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

4. Baza e vlerësuar për periudhën e përfitimit të pagës kalimtare, sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” dhe të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, është shuma e pagave mujore referuese sipas funksionit para se të fillonte trajtimi financiar sipas ligjeve të mësipërme, por brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

5. Baza e vlerësuar për periudhën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të policisë së shtetit”, është shuma e pagave mujore referuese sipas funksionit para se të fillonte trajtimi financiar sipas ligjeve të mësipërme, por gjithmonë brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

6.a) Baza e vlerësuar për periudhën e përfitimit të trajtimit, sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, është shuma e pagave minimale mbi të cilat janë paguar kontributet nga Buxheti i Shtetit për periudhën e përfitimit të trajtimit, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

6.b) Baza e vlerësuar për periudhën e përfitimit të trajtimit, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, është shuma e pagave mujore mbi të cilat janë paguar kontributet nga Buxheti i Shtetit, për periudhën e përfitimit të trajtimit, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

7. Baza e vlerësuar për periudhën e përfitimit të të ardhurave nga sigurimet shoqërore për sëmundje ose barrë lindje është shuma e bazës së vlerësuar mujore mbi të cilën është llogaritur përfitimi nga sigurimet shoqërore, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

Kur përfitimi është caktuar sipas pagave të periudhës para datës 1.1.1994, baza e vlerësuar për këtë periudhë, është shuma e pagave referuese të përcaktuara në tabelat A1, A2, A3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 12.8.2005, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

8. Baza e vlerësuar për periudhën kur përfituesi ka pasur pension invaliditeti të pjesshëm dhe gjatë trajtimit me këtë përfitim nuk ka qenë ekonomikisht aktiv, është shuma e bazave të vlerësuara mujore, mbi të cilën është llogaritur pensioni, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

Kur përfitimi është caktuar sipas pagave të periudhës para datës 1.1.1994, baza e vlerësuar për këtë periudhë është shuma e pagave referuese të përcaktuara në tabelat A1, A2, A3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 12.8.2005, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

9. Baza e vlerësuar për periudhën kur përfituesi ka përfituar pension invaliditeti të pjesshëm dhe gjatë trajtimit me këtë përfitim ka punuar me një pagë më të lartë se paga mbi të cilën i është llogaritur pensioni, është shuma e pagave mujore mbi të cilat janë paguar kontributet, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

10. Baza e vlerësuar për periudhën kur përfituesi ka përfituar pension invaliditeti të pjesshëm dhe sipas vendimit të KMCAP-it, ka punuar 6 orë në profesion, është shuma e pagave mujore mbi të cilat janë paguar kontributet, të ngritura në pagën ditore të plotë dhe të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

11. Baza e vlerësuar për periudhën para datës 1.1.1994, kur përfituesi ka përfituar pension invaliditeti të plotë, është shuma e pagave referuese të përcaktuara në tabelat A1, A2 dhe A3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 12.8.2005, sipas llojit të punës së kryer para invalidizimit, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve.

12. Për personat që periudhën e fundit të aktivitetit ekonomik, pas datës 1.1.1994, e kanë si të

vetëpunësuar në bujqësi dhe plotësojnë kushtet për pension qyteti, sipas nenit 96 paragrafët 1,2,3, si dhe për ata që plotësojnë kushtet për pension fshati, sipas nenit 96 paragrafi 4, baza mesatare e vlerësuar llogaritet mbi pagat minimale të caktuara në vitin përkatës me vendime të Këshillit të Ministrave, indeksuar me koeficientët vjetorë si më sipër.

13. Për periudhën gjatë së cilës personi ka derdhur kontribute në skemën e sigurimit vullnetar, baza e vlerësuar është shuma e pagave mbi të cilat është llogaritur kontributi vullnetar, të indeksuara me koeficientët sipas viteve, duke filluar nga viti që është bërë pagesa e kësteve të sigurimit.

III. Për efekt të llogaritjes të së ardhurës për invaliditet të përhershëm dhe të së ardhurës për invaliditet të pjesshëm të përhershëm, sipas nenit 48 dhe 49 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, paga mesatare mujore e tre viteve të fundit të punës nxirret nga shuma e pagave e përfituar për ato vite pjesëtuar me periudhën kalendarike. Shuma e përfitimit mujor nuk mund të jetë më pak se pensioni minimal.

IV. Me termin “pagë neto”, në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të neneve të tjera ku përmendet ky term, kuptohet masa që mbetet pasi nga paga bruto, sipas përmbajtjes së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, zbritet shuma që del nga zbatimi mbi këtë pagë i përqindjes së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pjesa që i përket punëmarrësit, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pjesa e tatimit mbi të ardhurat personale. Zbritjet nga paga bruto llogariten sipas përqindjeve dhe shumave të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi për periudhën përkatëse. Paga mesatare mujore neto llogaritet duke vënë në raport shumën e pagave mesatare neto të 3 viteve të njëpasnjëshme në dhjetë vitet e fundit të punës, të indeksuara sipas rregullave dhe koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar pjesëtuar me muajt kalendarikë të periudhës. Për efekt të llogaritjes së këtij treguesi në tri vitet rresht çdo muaj mund të përsëritet vetëm tri herë.

V. Udhëzimi i Këshillit Administrativ nr.1, datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni” do të zbatohet për raste kur data e lindjes të së drejtës për pension është nga 1.1.1997 deri në 15.6.2005.

VI. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15.6.2005.

KRYETARI I KËSHILLIT ADMINISTRATIV
Koço Barka

RREGULLORE

Nr.34/2, datë 5.10.2005

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR.34, DATË 1.2.2002 "PËR CAKTIMIN, ADMINISTRIMIN DHE PAGESËN E PENSIONEVE", E NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 74, germa “e” të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Administrativ i ISSH-së, në mbledhjen e tij të datës 5.10.2005, bëri këto shtesa e ndryshime në rregulloren nr.34, datë 1.2.2002 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar:

1. Kapitulli I “Kërkesa për pension”, bëhet kapitulli I/1 dhe para tij të shtohet kapitulli I, me këtë përmbajtje:

“Kërkesë paraprake për pension”

1. Për të përfituar të gjitha llojet e pensioneve të pleqërisë që parashikohen në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, personi i interesuar, deri në 5 muaj para se t’i lindë e drejta për pension, paraqet kërkesë me shkrim, sipas modelit të miratuar.

2. Kërkesa paraprake paraqitet nga vetë personi ose i autorizuari prej tij me prokurë të posaçme ose nga kujdestari ose nga familjari i tij i identifikuar me dokumentin përkatës.

3. Kërkesa paraprake së bashku me dokumentet paraqitet në Agjencinë Lokale të Sigurimeve Shoqërore (ALSSH) të vendbanimit të personit të interesuar.

4. Kërkesa paraprake shoqërohet me certifikatë lindje me fotografi dhe me fotokopje të librezës së punës, fotokopje të vërtetimeve të tjera që provojnë vjetërsinë në punë, fotokopje e librezës së kontributeve të paguara pas 1.1.1994. Nëse nuk paraqiten fotokopjet e këtyre dokumenteve, për ata që nuk i disponojnë, procedura do të vijojë mbi bazën e deklaramit të të dhënave nga personi i interesuar.

5. Në kohën që i interesuari për pension paraqet kërkesën, informohet me shkrim nga inspektori pritës për datën kur i lind e drejta për pension, si dhe procedurën që do të ndiqet me dokumentet paraprake.

6. ALSSH-ja pranon kërkesën me dokumentet e paraqitura. Bën regjistrimin e kërkesës në një regjistër të veçantë. Në regjistrë shënohet: numri rendor, data e paraqitjes së kërkesës, emri, atësia, mbiemri dhe adresa e plotë e kërkuarit.

7. Me dokumentet e kërkuarit krijohet një dosje. Në kapakun e parë të dosjes shënohet numri i kërkesës, emri, atësia, mbiemri dhe adresa e plotë e kërkuarit.

8. Për rastet kur dokumentacioni i periudhës së sigurimit ndodhet në drejtorinë rajonale ku kërkuari ka qendrën e banimit, ALSSH-ja që pret dokumentet, organizon edhe verifikimin e tyre. Afati i verifikimit në këtë rast do të jetë 30 ditë kalendrike nga data e dorëzimit të kërkesës paraprake.

9. Për rastet kur dokumentacioni i periudhës së sigurimit të kërkuarit duhet të verifikohet jashtë drejtorisë rajonale ku kërkuari ka qendrën e banimit, dokumentet dërgohen për verifikim në atë DRSSH, ku kërkuari ka punuar.

10. DRSSH-pritëse fillon procedurat e verifikimit. Afati për çdo rast verifikimi dhe kthim-përgjigje DRSSH-nisëse është 60 ditë kalendrike.

2. Në kapitullin I/1 “Kërkesa për pension”, pika 14 ndryshohet si vijon:

“14. Kërkesa shqyrtohet nga DRSSH-ja dhe merret vendim për caktimin e pensionit, brenda ditës së fundit të muajit të ardhshëm nga data e pranimit të kërkesës dhe të dokumenteve të plota e të sakta për pension në ALSSH.”.

3. Në kapitullin II “Dokumentet e nevojshme për caktimin e pensioneve sipas llojeve”, në shkronjën C “Të ardhurat”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Pasqyra e printuar e pagave referuese individuale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561, datë 12.8.2005.”.

4. Në kapitullin IV “Marrja e vendimit për caktimin e pensionit”, në pikën 1 paragrafi i shtatë, shprehja “15 vjeç” bëhet “18 vjeç”.

5. Në kapitullin VII “Plotësimi i librezës së pensionit”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Pasi caktohet pensioni, pensionistit në ALSSH, bashkë me librezën e pensionit, i vihen në dispozicion dy kopje të printuara të formularëve “Të dhëna për pagën neto në 10 vitet e fundit (të indeksuara)” dhe “Fletë llogaritje pensioni”. Nëse pensionisti është dakord, i nënshkruan, mban kopje dhe të tjerat mbeten në ALSSH. Kopjet dërgohen në DRSSH dhe ruhen në dosjen e pensionistit.”.

6. Në kapitullin IX “Pagesa e pensioneve”, bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, paguhen në Postën Shqiptare sh.a.

Pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjar, të caktuara nga data 1.1.2006 e në vazhdim, me kërkesë të pensionistit, mund të paguhen në bankat e nivelit të dytë.”.

- Paragrafi i fundit i pikës 3 ndryshon si vijon:

“Posta Shqiptare sh.a. dhe bankat e nivelit të dytë, pagesat e pensioneve i bëjnë me fondet e sigurimeve shoqërore sipas marrëveshjeve të lidhura.”.

7. Modelari tip i kërkesës paraprake për pension, i kërkesës për pension, si dhe modelarët e tjerë të parashikuar në rregulloren “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KËSHILLIT ADMINISTRATIV
Koço Barka

RREGULLORE
Nr.38, datë 7.9.2005

PËR KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 74 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Administrativ miratoi këtë rregullore:

I. PËRKUFIZIME

Termat:

“Shtetas” përfshin të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

“Persona ekonomikisht aktivë” përfshin të gjithë personat e punësuar, të vetëpunësuarit, punëdhënësit dhe personat me të ardhura të rregullta nga pronat, pasuria e patundshme ose burime të tjera të krahasueshme.

“Persona të tjerë ekonomikisht aktivë” përfshin të gjithë personat e vetëpunësuar dhe punëdhënësit.

“Persona të punësuar” përfshin të gjithë personat e punësuar me ose pa kontratë pranë një punëdhënësi.

“Persona të vetëpunësuar” janë personat e vetëpunësuar dhe personat me të ardhura të rregullta nga veprimtaria ekonomike.

“Punëdhënësi” përfshin të gjithë personat fizikë e juridikë që marrin në punë persona të tjerë me ose pa kontratë.

“Punonjësi i papaguar i familjes” përfshin anëtarët e familjes mbi 16 vjeç, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin dhe nuk kanë ndonjë punësim tjetër.

“Punonjësi i huaj dhe personat pa shtetësi” përfshijnë të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi që punojnë si punëdhënësi, të vetëpunësuar dhe të punësuar, në Shqipëri.

“Kontribut” përfshin të gjitha të ardhurat që paguhet për efekt të përfitimit dhe në zbatim të ligjit të sigurimeve shoqërore.

“Paga bruto” për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune, dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm, që lindin në marrëdhëniet e punës.

“Pagë minimale” kuptohet paga minimale bruto e detyrueshme për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Për efekt të llogaritjes dhe pagesës së kontributit të sigurimit shoqëror, shëndetësor, çdo punëdhënësi është i detyruar ta zbatojë këtë pagë edhe në rast se paga bruto e të punësuarit të tij mund të jetë më e vogël.

“Subjekte punëdhënëse” kuptohen të gjitha subjektet juridike e fizike, pavarësisht nga kufiri i regjistrimit në tatimin mbi vlerën e shtuar, të cilat për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike punësojnë persona të tretë, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Punës, Statusin e Nëpunësit Civil apo sipas marrëveshjeve të veçanta.

“Subjekte të vetëpunësuar” kuptohen subjektet juridike e fizike private, të cilat e ushtrojnë vetë aktivitetin ekonomik. Për efekt të regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore, në subjektet e vetëpunësuar regjistrohen edhe ortakët e bashkëpronarët që ushtrojnë veprimtari ekonomike (punojnë) me subjektin në bashkëpronësi.

“Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore” kuptohet shuma e kontributeve dhe kamatëvonesave, të llogaritura nga administrata e sigurimeve shoqërore, por të paguara nga subjekti brenda afateve të

përcaktuara me ligj.

II. PROCEDURAT E KONTRIBUTEVE

Me ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.771, datë 13.11.2003, të ndryshuar, shërbimin e mbledhjes së kontributeve e kryejnë organet tatimore. Mbështetur në nenin 3 “Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve”, të ligjit të mësipërm, kontributet mblidhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto kushte punonjësve të kontributeve u ka mbetur funksioni i evidentimit dhe i raportimit të realizimit të të ardhurave, kontrolli i listëpagesave dhe nxjerrja e të dhënave.

Me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar, kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi dhe të personave të siguruar vullnetarisht mblidhen nga organet e sigurimeve shoqërore.

A. Regjistrimi për herë të parë

Subjektet punëdhënëse, që fillojnë aktivitet për herë të parë, duhet të pajisin personat për të cilët paguajnë kontribute me Numrin e Sigurimit Shoqëror (NSSH), të cilin e tërheqin nga organet e sigurimeve shoqërore. Për këtë punëdhënësit duhet të paraqesin kërkesë në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore “Për pajisjen e punonjësve me NSSH” me listën emërore të punonjësve, sipas formularit tip, bashkëlidhur.

Subjektet e vetëpunësuar, që fillojnë aktivitet për herë të parë, duhet të pajisen me Numrin e Sigurimit Shoqëror (NSSH), të cilin e tërheqin nga organet e sigurimeve shoqërore.

Të vetëpunësuarit në bujqësi regjistrohen në regjistrat e sigurimeve shoqërore pas verifikimit, nga inspektori i sigurimeve shoqërore, të:

- vërtetimit të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronësinë mbi tokën;
- certifikatës së gjendjes civile.

Regjistrimi në regjistrin e kontributeve për personat e vetëpunësuar në bujqësi shoqërohet me një kopje të formularit tip “Njoftim për pagesën e kontributeve të sigurimeve për të vetëpunësuarin në bujqësi”, sipas formularit tip, bashkëlidhur.

B. Ndryshimet e deklaramit të mëparshëm

Punëdhënësi, në çdo rast të punësimit të ri, duhet të paraqesë kërkesë “Për pajisjen e punonjësve me NSSH” dhe do të sjellë listë shtesë për pajisjen e tyre me numër sigurimi. Lista paraqitet në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore të rrethit, sipas formularit tip, bashkëlidhur dhe shoqërohet me:

- Dokumentin e Inspektoratit të Punës;
- Certifikatën familjare, për rastet e punësimit të anëtarëve të papaguar të familjes të përfaqësuesit të personit juridik ose ortakëve.

III. DETYRIME TË ADMINISTRATËS SË SIGURIMEVE SHOQËRORE

1. Publikimi i legjislacionit. Administrata qendrore, rajonale dhe lokale e sigurimeve shoqërore është e detyruar të publikojë e të qartësojë të gjithë personat juridikë e fizikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik mbi detyrimin ligjor, për të paguar kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe për çdo ndryshim të legjislacionit. Publikimet dhe qartësimi i legjislacionit realizohen nëpërmjet organeve të medias, fletëpalosjeve, njoftimeve të përgjithshme dhe njoftimeve të veçanta.

2. Pajisja me numrin e regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore.

Në momentin e regjistrimit për herë të parë, administrata e sigurimeve shoqërore në drejtoritë rajonale dhe në agjencitë e sigurimeve shoqërore (për ato agjenci që kanë autorizim nga ISSH-ja) i pajis subjektet me numrin e regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore dhe një kopje të aktmarrëveshjes.

IV. DETYRIMI PËR TË PAGUAR KONTRIBUTET

1. Për institucionet buxhetore, deri më datë 1 qershor 2005, ishin procedurat mbështetur në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar. Nga data 1 qershor 2005 edhe për këto subjekte veprohet sipas udhëzimit të përvitshëm të Ministrit të Financave “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

2. Për subjektet tatimpaguese dhe ato me qendër në Tiranë, të regjistruara në degën e tatimpaguesve të mëdhenj; tatimpagues të regjistruar në mbështetje të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe për një pjesë të tatimpaguesve të regjistruar në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin”, në marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës, do të veprohet sipas udhëzimit të përvitshëm të Ministrit të Financave “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

3. Për të vetëpunësuarit në bujqësi do të ndiqen dhe zbatohen të gjitha procedurat mbështetur në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë””, i ndryshuar.

A. Personat që detyrohen të paguajnë kontribute

Mbështetur në aktet e mësipërme ligjore dhe nënligjore detyrohen të paguajnë kontribute për sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor:

1. Të gjithë personat juridikë e fizikë dhe të punësuarit në këto subjekte.

2. Personat e vetëpunësuar në bujqësi, të cilët e zhvillojnë vetë aktivitetin bujqësor ose blegtoral.

B.Nuk janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimit të detyrueshëm:

Personat e vetëpunësuar në bujqësi për kohën që trajtohen me ndihmë të plotë ose të pjesshme ekonomike.

C. Llojet e kontributeve

1. Për personat e punësuar. Personat e punësuar dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribute për sëmundje, barrë lindje, pensione dhe sigurime shëndetësore, në një shumë e cila varet nga paga e tyre bruto. Veç këtyre punëdhënësi është i detyruar të paguajë kontribute të sigurimeve shoqërore, për punëmarrësit e tij edhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe për papunësi.

2. Personat e tjerë ekonomikisht aktivë paguajnë kontribute për barrë lindje, për pensione dhe për sigurimet shëndetësore.

3. Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë kontribute për barrë lindje, për pensione dhe për sigurimet shëndetësore. Përqindjet e kontributit përcaktohen sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. PROCEDURAT E LLOGARITJES DHE TË PAGESËS SË KONTRIBUTEVE

Kontributet mblihen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Detyrimi për llogaritjen dhe pagimin e kontributeve

1. Kontributet për personat e punësuar me kontratë pune, vendim emërimi, marrëveshje etj., llogariten dhe paguhen nga punëdhënësi. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarit shumën e kontributit të sigurimeve shoqërore, që ligjërisht përballohet nga punëmarrësi sipas përqindjeve të përcaktuara në ligjin e sigurimeve shoqërore, mbi pagën bruto dhe bashkë me pjesën e tij sipas përqindjeve të caktuara në ligj, mbi pagën bruto sipas listëpagesave, ta paguajë në llogaritë e organeve tatimore për fondin e sigurimeve shoqërore.

2. Të vetëpunësuarit, ortakët e vetëpunësuar, bashkëpronarët e vetëpunësuar, për veten e tyre, janë të detyruar të llogaritin dhe paguajnë kontributet në llogaritë e organeve tatimore për fondin e sigurimeve shoqërore.

3. Kontributet e sigurimeve shoqërore shëndetësore për personat e papaguar të familjes

llogariten dhe paguhën në llogaritë e organeve tatimore për fondin e sigurimeve shoqërore nga punëdhënësit, të vetëpunësuarit, ortakët apo bashkëpronarët, si përqindje (të përcaktuar me ligj) mbi pagën minimale (të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave).

4. Personat e vetëpunësuar në bujqësi i paguajnë vetë kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në llogaritë e sigurimeve shoqërore.

VI. AFATET E PAGESAVE TË KONTRIBUTEVE

Mbështetur në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pagesat e kontributeve, me deklarata, bëhen në afatet e mëposhtme:

- Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri, si administratorë ose çdo funksion tjetër, trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

- Nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit;

- Nga personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri, si administratorë ose çdo funksion tjetër, trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

- Nga personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, brenda datës 10 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes, si dhe të punësuarit.

VII. TË ARDHURAT MBI TË CILAT LLOGARITEN DHE PAGUHEN KONTRIBUTET

Paga bruto

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.771, datë 13.11.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune, dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm, që lindin në marrëdhëniet e punës.

Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nuk përfshihen:

- a) përfitimet që punëmarrësi merr, në mënyrë të përhershme, nga fondet e sigurimeve shoqërore;

- b) kompensimet nga rritja e çmimeve;

- c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;

- ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykatë;

- d) vlera e antidodeve, që punëdhënësi jep në natyrë për personat e punësuar sipas legjislacionit në fuqi;

- dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive, për sëmundjet e gjata, për dëme në raste fatkeqësish të mëdha natyrore e për veprimtari të shquara;

- e) vlera e shpenzimeve për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit;

- ë) honoraret apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet e punës.

Paga bruto, për efekt të llogaritjes e pagimit të kontributeve, nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kontributet llogariten deri në një pagë maksimale, e cila është sa 5-fishi i pagës minimale.

Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, llogariten e paguhën edhe për të

ardhurat nga paga dhe shtesat mbi pagat nga një punë e dytë.

Mbështetur në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.4, datë 18.1.2005 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore”, në qoftë se një nga punëmarrësit punon në dy punë, atëherë për këtë punëmarrës, secili prej punëdhënësve të tij (personi juridik ose personi fizik) llogarit dhe paguan kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore njësoj sikur personi të mos ishte i punësuar në punëdhënës tjetër. Pra, secili prej punëdhënësve, në mënyrë të pavarur, llogarit dhe paguan kontributet mbi bazën e pagës reale të punëmarrësit, brenda kufirit maksimal të miratuar.

Edhe në rastet e të vetëpunësuarve, kur i vetëpunësuari është njëkohësisht edhe punëmarrës në një punëdhënës, atëherë ai duhet të regjistrohet në degën e tatimeve dhe të paguajë kontributet dhe detyrimet e tjera si i vetëpunësuar, sipas të gjitha rregullave, njësoj sikur të mos ishte edhe punëmarrës. Ndërkohë ai duhet gjithashtu të paguajë kontributet edhe si punëmarrës të një punëdhënësi tjetër. Punëdhënësi, ku i vetëpunësuari është punëmarrës, bën të gjitha veprimet njësoj si për gjithë punëmarrësit, sikur personi të mos ishte edhe i vetëpunësuar. Kontributi total i paguar nga i njëjti person (si i vetëpunësuar edhe si punëmarrës) nuk mund të jetë më i madh se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale të miratuar.

Rimbursimi

Sipas udhëzimit të mësipërm, kur rezulton që kontributi total i paguar për të njëjtin person nga të dy punëdhënësit është më i madh se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale të miratuar, punëmarrësit i rimbursohet diferenca në mënyrë proporcionale nga të dy punëdhënësit, brenda 30 ditëve nga zbulimi i mbipagesës apo njoftimi për këtë të fundit.

Edhe në rastet e të vetëpunësuarve, kur i vetëpunësuari është njëkohësisht edhe punëmarrës në një punëdhënës, kur rezulton që kontributi total është më i madh se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale të miratuar, të vetëpunësuarit dhe punëmarrësit i rimbursohet diferenca në mënyrë proporcionale, brenda 30 ditëve nga zbulimi i mbipagesës apo njoftimi për këtë të fundit.

Në këto raste, janë organet tatimore që do të bëjnë njoftimet përkatëse.

Përveç kësaj, agjencitë e sigurimeve shoqërore do të bëjnë verifikimet përkatëse dhe kundrejt kërkesës së punëdhënësit apo personit përfitues, sipas formatit tip, bëhet rimbursimi.

Për personat e vetëpunësuar në bujqësi

Masa e kontributit për sigurimin shoqëror të të vetëpunësuarve në bujqësi përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për masën në vlerë të kontributit për të vetëpunësuarit në bujqësi do të bëhet referimi te vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave. Dallimet në masën e kontributit sipas zonave përcaktuar në këtë vendim.

Llogaritja e pagës, për efekt të pagimit të kontributeve, kur rezultojnë ndërprerje në punë

Mbështetur në pikën 3 të nenit 9 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në rast se veprimtaria ekonomike e subjektit, me anë të një deklarate, ndërpritet për një periudhë, vlera e kontributit për t’u paguar zvogëlohet përpjesëtimisht, në përputhje me formulën e përcaktuar me udhëzimin e Ministrit të Financave, si më poshtë:

Në rastet kur kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar fizikë dhe punonjësit e papaguar të familjes llogariten si përqindje e pagës mujore minimale dhe veprimtaria ekonomike fillon, përfundon apo ndërpritet për një periudhë prej së paku një muaj të plotë kalendarik gjatë një periudhe deklarimi, dhe fillimi, mbyllja apo ndërprerja e veprimtarisë ekonomike i është njoftuar degës së tatimeve me shkrim, shuma e kontributeve për t’u paguar do të llogaritet sipas formulës:

A. (numri i muajve të plotë apo të pjesshëm brenda periudhës së deklarimit gjatë së cilës është kryer veprimtaria ekonomike)

B. (numri i muajve të plotë gjatë periudhës së deklarimit)

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për efekt të kontrollit të zbatimit të kufijve minimalë e maksimalë të pagave, bëhet proporcionalisht me kohën e punuar.

Kështu:

- Llogaritja e pagës mujore për efekt të pagimit të kontributeve, kur rezultojnë ndërprerje apo mungesa në punë, në rast se mungesat janë të vërtetuara me raport mjekësor apo çdo dokumentacion tjetër të parashikuar nga Kodi i Punës apo ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, bëhet mbi pagën ditore faktike shumëzuar me ditët e punuara në fakt. Subjektet punëdhënëse janë të detyruara të bëjnë shënimet përkatëse në regjistrin e pagave të punonjësve për kohën dhe arsyet e ndërprerjes së punës.

- Llogaritja e pagës mujore për efekt të pagimit të kontributeve, kur rezultojnë ndërprerje të përkohshme (orare) në punë të parashikuara nga Kodi i Punës dhe të dokumentuara për çdo rast nga punëdhënësi, bëhet mbi pagën orare faktike shumëzuar me orët e punuara në fakt, shumëzuar me ditët e punuara në fakt. Subjektet punëdhënëse janë të detyruara të bëjnë shënimet përkatëse në regjistrin e pagave të punonjësve për kohën dhe arsyet e ndërprerjes së punës.

- Llogaritja e pagës mujore për efekt të pagimit të kontributeve, në kufijtë e pagës minimale e maksimale, kur rezultojnë ndërprerje apo mungesa në punë, por mungesat nuk janë të vërtetuara me raport mjekësor apo çdo dokumentacion tjetër të parashikuar nga Kodi i Punës apo ligji për Statusin e Nëpunësit Civil, bëhet mbi pagën ditore bazë të parashikuar në kontratë, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar, shumëzuar ditët e punës për muajin, të parashikuara në kontratën e punës.

Nuk quhen të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe nuk u nënshtrohen llogaritjes së kontributeve përfitimet që punëmarrësi merr, në mënyrë të përhershme, nga fondet e sigurimeve shoqërore; kompensimet nga rritja e çmimeve, dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm, të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuar me vendim gjykatë; vlera e antidodeve, që punëdhënësi jep në natyrë për personat e punësuar sipas legjislacionit në fuqi; shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë për rastet e fatkeqësive, për sëmundjet e gjata, për dëme në raste fatkeqësish të mëdha natyrore e për veprimtari të shquara; vlera e shpenzimeve për të punësuarit që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit; honoraret apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet e punës.

VIII. DEBITORËT

1. Detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore përfaqëson shumën e llogaritur për kontributet e papaguara brenda afateve ligjore. Kështu detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore përfaqëson shumën e kontributeve të papaguara brenda afateve ligjore dhe shumën e kamatëvonesave të arrira, të llogaritura mbi kontributet e paderdhura.

Detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore llogaritet në bazë të deklarimit të subjektit të bërë në organet tatimore ose në bazë të listëpagesave të dorëzuara.

2. Detyrimet e prapambetura para kalimit të subjektit në organet tatimore

Gjatë vitit 2003, 2004 dhe deri më 31.5.2005 janë realizuar katër faza të transferimit të subjekteve në organet tatimore për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

a) Faza e parë e transferimit për tatimpaguesit me qendër në Tiranë, të regjistruar në degën e tatimpaguesve të mëdhenj, është realizuar më 1 nëntor 2003. Për këto subjekte janë fiksuar detyrimet kontributive të prapambetura dhe të papaguara deri në fund të muajit tetor të vitit 2003. Shuma e detyrimeve kontributive të prapambetura nuk ndryshon më, përveç rasteve kur ato likuidohen pjesërisht ose plotësisht. Ndërsa kamatëvonesat vazhdojnë të llogariten mbi shumën e fiksuar të detyrimit kontributiv, pra janë në rritje.

b) Faza e dytë e transferimit për tatimpaguesit e regjistruar në mbështetje të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është realizuar më 1 maj 2004. Për këto subjekte, janë fiksuar detyrimet kontributive të prapambetura dhe të papaguara deri në fund të muajit prill të vitit 2004. Shuma e detyrimeve kontributive të prapambetura nuk ndryshon më, përveç rasteve kur ato likuidohen pjesërisht ose plotësisht. Ndërsa kamatëvonesat vazhdojnë të llogariten mbi shumën e fiksuar të detyrimit kontributiv, pra janë në rritje.

c) Faza e tretë e transferimit për tatimpaguesit e regjistruar në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin”, është realizuar më 1 janar 2005. Për këto subjekte janë fiksuar detyrimet kontributive të prapambetura dhe të papaguara deri në fund të vitit 2004. Shuma e detyrimeve kontributive të prapambetura nuk ndryshon më, përveç rasteve kur ato likuidohen pjesërisht ose plotësisht. Ndërsa kamatëvonesat vazhdojnë të llogariten mbi shumën e fiksuar të detyrimit kontributiv, pra janë në rritje.

d) Faza e katërt e transferimit për institucionet buxhetore është realizuar më 1 qershor 2005. Edhe për këto subjekte janë fiksuar detyrimet kontributive të prapambetura dhe të papaguara deri në fund të muajit maj të vitit 2005. Shuma e detyrimeve të kontributive të prapambetura të rezultuara nuk ndryshon më, përveç rasteve kur ato likuidohen pjesërisht ose plotësisht. Ndërsa kamatëvonesat vazhdojnë të llogariten mbi shumën e fiksuar të detyrimit kontributiv, pra janë në rritje.

3. Detyrimet e prapambetura të krijuara pas kalimit të subjektit në organet tatimore

Mbledhja e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitore, pas kalimit të tyre në organet tatimore, do të bëhet nga degët e tatimeve si për detyrimet e rezultuara para transferimit të shërbimit të mbledhjes së kontributeve nga organet tatimore, ashtu dhe për detyrimet e krijuara pas transferimit të tyre.

Evidentimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara do të bëhet sipas evidencës së subjekteve debitore, formati tip.

Për subjektet debitore, shkëmbimi i të dhënave ndërmjet Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore dhe degëve të tatimeve do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktmarrëveshjen e përbashkët të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve “Për shkëmbimin e të dhënave pas transferimit të funksionit të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura të kontributeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe procedura për identifikimin e ritransferimin e gjobave”.

Në bazë të nenit 19 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, masa e interesit për pagesë të vonuar të kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore është 2 për qind për muajin e parë të vonësës ose pjesë të tij dhe 1 për qind për çdo muaj apo pjesë të tij që vijon.

IX. BASHKËPUNIMI ME ORGANET TATIMORE

Në agjencitë në nënqark, ku ka degë tatimore, një punonjës kontributësh do të jetë për koordinimin dhe bashkëpunimin e punës me organet tatimore.

Bashkëpunimi konsiston:

- në ndjekjen dhe realizimin e të ardhurave të programuara nga subjektet që kanë kaluar në organet tatimore;
- në rakordimin e pagesave të kryera nga subjektet në organet e sigurimeve shoqërore ndërkohë që këto pagesa duhet të kryheshin në organet tatimore;
- në evidentimin e subjekteve debitore;
- në ndjekjen e ardhjes së listëpagesave nga organet tatimore;
- në ndjekjen e listave të subjekteve që kanë paguar kontribute të sigurimeve shoqërore me numrin dhe pagën mesatare.

X. PROCEDURAT PËR TRAJTIMIN E DOKUMENTEVE TË ARDHURA

1. Listëpagesat, inventarizimi, kontrolli dhe arkivime

a) Mbështetur në shkronjën “g” pika 8 e udhëzimit të Ministrit të Financave nr.4, datë 18.1.2005 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, degët e tatimeve do të dërgojnë zyrtarisht listëpagesat origjinale të sigurimeve shoqërore dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, sipas formatit të miratuar (E-SIG 025/a), brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim.

Dorëzimi i listëpagesave nga degët e tatimeve do të bëhet, çdo muaj, me shkresë zyrtare, ku të jenë të listuara të gjitha subjektet që kanë dorëzuar listëpagesat e punonjësve, të jetë përcaktuar numri i fletëve të listëpagesës dhe numri i të siguruarve. Listëpagesat do të jenë të firmosura dhe të vulosura për çdo fletë.

b) Me ardhjen e listëpagesave, do të bëhet inventarizimi fizik i tyre nga punonjësi i kontributeve. Pas inventarizimit fizik të tyre, në çdo rast, bëhet konfirmimi zyrtar i marrjes në dorëzim të listëpagesave dhe nënshkruhet akti i marrjes në dorëzim.

c) Pas përfundimit të inventarit fizik, bëhet kontrolli i tyre për ruajtjen e nivelit minimal dhe maksimal të pagave mbi të cilin janë paguar kontributet, për llogaritjen e kontributit të sigurimit shoqëror, kontributit kundrejt ditëve të punuara, etj.

d) Nëse ka mangësi në listëpagesat e inventarizuara dhe të kontrolluara, së bashku me konfirmimin e marrjes së tyre në dorëzim, bëhen edhe reklamimet përkatëse, duke evidentuar mangësitë e listëpagesave për çdo subjekt.

2. Regjistrimi i subjekteve juridike dhe fizike me punëmarrës

a) Pas inventarizimit dhe kontrollit të listëpagesave, fillon procesi i regjistrimit në “Regjistrin vjetor të subjekteve juridike dhe fizike me punëmarrës”, sipas formatit tip, bashkëlidhur. Për plotësimin e tij do të shërbejnë listëpagesat deri në pjesën e kontributit të llogaritur, ndërsa për kontributin e paguar do të bëhet rakordimi i shumës së dërguar, me format elektronik nga degët e tatimeve, me të dhënat e pagesës së tyre në financë. Këto të fundit do të hidhen në regjistër.

b) Në rastet kur kontributet nuk janë xhiruar në llogarinë e sigurimeve shoqërore ose nga llogaritjet e bëra ka diferenca të papaguara, njoftohet zyrtarisht dega e tatimeve për xhirimin e kontributeve ose diferencave të rezultuara.

3. Arkivimi i dokumentacionit të kontributeve dhe afatet

a) Listëpagesave të subjekteve juridike dhe fizike me punëmarrës do t’u shënohet numri i punonjësve në fund të çdo faqeje, do të nënshkruhen nga inspektori i kontributeve dhe do të vulosen me vulën e agjencisë në çdo faqe. Këto listëpagesa duhet të arkivohen brenda 45 ditëve nga ardhja e tyre. Dorëzimi i listëpagesave do të bëhet me procesverbal, sipas formularit tip, bashkëlidhur. Punonjësit e arkivit, pas marrjes së tyre në dorëzim, fillojnë vendosjen e tyre në dosjen e çdo subjekti.

b) Regjistri vjetor i subjekteve juridike dhe fizike me punëmarrës dhe regjistri i subjekteve juridike dhe fizike pa punëmarrës dorëzohet çdo vit në arkivë, pasi përfundon regjistrimi dhe evidentimi i të dhënave të kontributive për çdo subjekt. Ato sekretohen dhe pas kësaj dorëzohen në arkiv me procesverbal dorëzimi, ku nënshkruan punonjësi i kontributeve si dorëzues dhe arkivisti si marrës në dorëzim.

c) Së bashku me regjistrat vjetorë dorëzohen edhe të dhënat e përpunuara për kontributet, të cilat i kanë dërguar degët e tatimeve në format elektronik. Këto të dhëna i bashkëlidhen regjistrave përkatës.

4. Subjektet debitore dhe kreditore për rimbursim

a) Subjektet debitore që kanë rezultuar deri në momentin e transferimit të tyre në organet tatimore, sipas fazave të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, do të vazhdojnë të mbahen si të tilla deri në momentin e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura. Për këto detyrime do të vazhdojë të llogaritet kamatëvonesë dhe do të ketë procedurë të veçantë ndjekjeje, sipas aktmarrëveshjes së përbashkët të ISSH-së, ISKSH-së dhe DPT-së “Për shkëmbimin e të dhënave pas transferimit të funksionit të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura të kontributeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe procedura për identifikimin e ritransferimin e gjobave”.

b) Për subjektet debitore që kanë rezultuar pas kalimit të tyre në organet tatimore, do të ketë evidentim të tyre në evidencen e debitorëve.

c) Në zbatim të pikës 7 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.4, datë 18.1.2005 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, për subjektet që duhet të rimbursohen, do të ketë njoftim nga dega e tatimeve. Pas këtij njoftimi dhe në prani të përfaqësuesit të subjektit që kërkon rimbursim, do të mbahet një procesverbal në tri kopje. Fleta e parë e procesverbalit i jepet financës për të bërë xhirimin e shumës që rezulton për rimbursim, një kopje i jepet përfaqësuesit të subjektit dhe një e mban punonjësi i kontributeve, sipas procesverbalit tip, bashkëlidhur.

5. Të dhënat dhe raportimet statistikore

a) Mbështetur në pikën 3.1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.771, datë 13.11.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të dhënat bazë do të na dërgohen nga organet tatimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim. Mbështetur në këto të dhëna, ju do të bëni raportimet statistikore brenda afateve të përcaktuara.

b) Pas këtij raportimi, në një afat kohor prej 15 ditësh, nga drejtoritë rajonale do të përpunohen të dhënat e grumbulluara dhe do të raportohen ato të ndara sipas subjekteve. Pra për subjektet buxhetore, jobuxhetore, firma, të vetëpunësuar privatë, të vetëpunësuar në bujqësi dhe sigurim vullnetar.

6. Dhënia e vërtetimeve

a) Mbështetur në shkronjën “g” pika 8 e udhëzimit të Ministrit të Financave nr.4, datë 18.1.2005 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”,

për kohën që listëpagesa e sigurimeve shoqërore (E-SIG 025/a), për personin juridik e fizik përkatës, është likuiduar plotësisht, por nga dega e tatimeve nuk është dërguar akoma në organet e sigurimeve shoqërore, vërtetimet për kontributet e paguara, që kërkojnë tatimpaguesit dhe individët kontribues, lëshohen zyrtarisht nga organi tatimor përkatës.

b) Për periudhën kur dega e tatimeve i ka dërguar listëpagesat, atëherë vërtetimet do të lëshohen nga ana juaj, sipas modeleve të vërtetimeve, bashkëlidhur udhëzimit.

7. Pajisja e personave me numrin e sigurimit shoqëror; regjistrimi

a) Mbështetur në pikën 1 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.4, datë 18.1.2005 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisin personat për të cilët paguajnë kontribute me numrin e sigurimit shoqëror (NSSH), të cilin e tërheqin nga organet e sigurimeve shoqërore. Për këtë punëdhënësit duhet të paraqesin listën emërore të punëmarrësve sipas formularit tip, bashkëlidhur. Në çdo rast të punësimit të ri, punëdhënësi do të sjellë listë shtesë për pajisjen e tyre me numër sigurimi.

Subjekteve që hapin aktivitet për herë të parë dhe që do të paraqiten për marrjen e numrit të sigurimit shoqëror do t’u kërkohej:

- kopje e vendimit të gjykatës;
- certifikatë personale e punëdhënësit;
- lista emërore e punonjësve, sipas formatit tip.

Pas kësaj subjektit të ri do t’i vendoset numri në regjistrin e subjekteve dhe me këtë numër do t’i hapet dosja përkatëse në arkivë.

b) Me transferimin e funksionit të mbledhjes së kontributeve në organet tatimore, nuk bëhen më regjistrime apo reregjistrime subjektsh, përveç regjistrimeve të subjekteve të reja.

XI. DOKUMENTACIONI

A. Dokumentacioni i kontributeve

1. Regjistri i subjekteve juridike dhe fizike me punëmarrës për vitin;

2. Regjistri i subjekteve fizike pa punëmarrës për vitin;

3. Procesverbale:

a) Procesverbal “Mbi dorëzimin e listëpagesave të subjekteve në arkivë”;

b) Procesverbal “Për rimbursimin e kontributeve të paguara tepër”;

4. Kërkesë “Për pajisjen e punonjësve me NSSH”;

5. Vërtetime:

a) Vërtetim për personat juridikë/fizikë “Për kontributet e sigurimeve shoqërore”;

b) Vërtetim për personat fizikë “Për kontributet e sigurimeve shoqërore”;

6. Evidenca e debitorëve;

7. Dokumentacioni i të vetëpunësuarve në bujqësi:

a) Regjistri themeltar i të vetëpunësuarve në bujqësi;

b) Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi (për efekt përfitimi nga ligji i sigurimeve shoqërore);

c) Vërtetim për të vetëpunësuarat në bujqësi për barrë lindje;

d) Vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi për pagesat e kontributeve;

8. Dokumentacioni për skemën e sigurimit vullnetar është miratuar me rregulloren e sigurimit vullnetar.

B. Afatet e plotësimit të dokumentacionit dhe lëvizja e tyre

Dokumentet e kontributeve dhe rregullat bazë për plotësimin e tyre janë të detyrueshme për t’u zbatuar në mënyrë unike nga të gjitha organet dhe punonjësit përkatës të sigurimeve shoqërore. Këto dokumente tip janë pjesë dhe aneks i kësaj rregulloreje.

Të gjitha dokumentet e kontributeve plotësohen me përgjegjësi nga punonjësit përkatës, ato ruhen dhe administrohen sipas afateve e rregullave të administrimit dhe arkivimit.

Përgjegjës për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit janë punonjësit që i kanë në përdorim sipas përkatësisë.

Detyra për inventarizimin dhe administrimin e dokumentacionit të përfundojë brenda muajit prill të çdo viti për dokumentet e vitit të mëparshëm.

Për ndryshime në dokumentet tip, që janë pjesë dhe aneks i kësaj rregulloreje, autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së.

XII. Rregullorja e kontributeve nr.36, datë 24.10.2002, shfuqizohet.
XIII. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Engjell Bejtja

REGJISTRI I SUBJEKTEVE JURIDIKE DHE FIZIKE ME PUNEMARRES PER VITIN.

[illegible]

REGJISTRIT I SUBJEKTEVE FIZIKE PA PUNEMARRRES PER VITIN

[illegible]

(Per rimbursimin e kontributeve te paguara teper)

I mbajtur sot ne date _____ 2005, midis inspektorit te kontributeve te agjensise _____ dhe perfaqesuesit te subjektit _____ Z _____

er rimbursimin e kontributit te paguar teper, te njoftuar nga dega e tatimeve _____ me

hkresen nr. _____ date _____ per punemarresin z _____ i cili ka punuar ne subjektet

Nga verifikimi i listepagesave te dorezuara nga subjektet rezulton se jane paguar teper kontribute shoqerore ipas pasqyres se meposhtme:

Nr.	Emertimi subjektivit	Nipti	Periudha	Kontributi shqetor		Shuma e kontr. maksimal	Diferenca e rimbursimit
				I llogaritur	I derdhur		
	Shuma						

Shuma e rimbursimit të kontributit të paguar tepër _____ leke (_____)
e cilat kalojnë në llogarinë e subjektit _____.

Ky proces-verbal mbahet në tre kopje, kopja origjinale i jepet degës së Finances për të kryer veprimet përkatëse dhe kopje i jepet përfaqësuesit të subjektit dhe një kopje e mban inspektori i kontributeve.

Pergjegjesi Agjensise

()

Emertimi i subjektit _____

Nr. niptit _____

Nr.regj. Sigurimeve shoqerore

KERKESE
(Per paisjen e punonjesve me NSSH)

Lista emerore e punonjesve

Nr.	Emer Atesia Mbiemer	Mbiemri vajzerise	Datelindja		
			data	muaji	viti

Data _____

Nenshkrimi i punedhenesit

(_____)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 INSTITUTI SIGURIMEVE SHOQERORE
 Drejtoria Rajonale _____
 Agjensia e Sigurimeve Shoqerore _____

Nr. _____ Prot.

Ne _____ me _____

VERTETIM
 (Per kontributet e sigurimeve shoqerore)

Vertetojme se Personi Juridik / Fizik _____ I perfaqesuar nga z. _____
 me numer NIPTI-I _____, ne mbeshtetje te formulareve " Listepagesa e kontributeve per sigurimet
 shoqerore, shendetesore dhe tatimi mbi te ardhurat nga punesimi" E-SIG 025/a, te cilat jane te likujduara plotesisht.
 Ka paguar kontributet e sigurimeve shoqerore si me poshte:

Nr.	Muaji	Viti	Numeri i Kontribuesve (me shifra)	Numeri i Kontribuesve (me shkrim)
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
	SHUMA			

Vertetimi leshohet me kerkesen e Personit Juridik / Fizik.

V.O! KY VERTETIM ESHTË I VLEFSHEM KUR NUK KA ASNJE KORIGJIM.

Nje kopje e ketij Vertetimi me siglen e Inspektorit pergjegjes ruhet ne protokoll dhe arshivohet sipas rregullave.

Drejtore / Pergjegjese i Agjensise

(.....)

VULA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 INSTITUTI SIGURIMEVE SHOQERORE
 Drejtoria Rajonale _____
 Agjensia e Sigurimeve Shoqerore _____

Nr. _____ Prot. _____

Ne _____ me _____

VERTETIM
 (Per kontributet e sigurimeve shoqerore)

Vertetojme se Personi Juridik / Fizik _____ i perfaqesuar nga z. _____ me numer NIPTI-i _____, ne mbështetje te formulareve " Listepagesa e kontributeve per sigurimet shoqerore, shendetesore dhe tatimi mbi te ardhurat nga punesimi" E-SIG 025/a, te cilat jane te likujduara plotesisht, ne emrin e Z. _____ i identifikuar me numer sigurimi shoqeror _____ jane paguar kontributet e sigurimeve shoqerore si me poshte:

Nr.	Muaji	Viti	Leke (me shifra)	Leke (me shkrim)
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
	SHUMA			

Vertetimi leshohet me kerkesen e Personit.

V.O! KY VERTETIM ESHTË I VLEFSHEM KUR NUK KA ASNJE KORIGJIM.

Nje kopje e ketij Vertetimi me siglen e Inspektorit pergjegjes ruhet ne protokoll dhe arshivohet sipas rregullave.

Drejtori / Pergjegjesi i Agjensise

(.....)
 VULA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSTITUTI SIGURIMEVE SHOQERORE
Drejtoria Rajonale _____
Agjensia e Sigurimeve Shoqerore _____

Mod. -19-
Nr. serie

Nr. _____ Prot.

Ne _____ me _____

VERTETIM
(Per pjesmarrje ne TENDER)

Ne pergjigje te kerkeses te Z., perfaqesues i subjektit Juridik/ Fizik
..... me numer NIPT-i i cili pergatitet te marre pjese ne tenderin qe
zhvillohet ne daten, sipas fteses te bere nga enti prokurues (institucioni)
..... me objekt prokurimi
me vlere leke, me vendndodhje ne, vertetojme se:

Subjekti i lartpermendur eshte regjistruar ne Regjistrin Themeltar te Kontributeve ne Agjensine e Sigurimeve
Shoqerore te rrethit me nr.Regjistri

Ka paguar kontributet e sigurimeve shoqerore si me poshte:

Nr.	Muaji	Viti	Numeri i Kontribuesve (me shifra)	Numeri i Kontribuesve (me shkrim)
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
	SHUMA			

Subjekti ka paguar rregullisht detyrimet ndaj sigurimeve shoqerore deri ne muajin Viti,
ose ai eshte debitor per shumen (.....) leke.

V.O! KY VERTETIM ESHTË I VLEFSHEM KUR NUK KA ASNJE KORIGJIM.

Nje kopje e ketij Vertetimi me siglen e Inspektorit pergjegjes ruhet ne protokoll dhe arshivohet sipas rregullave.

Drejtori / Pergjegjesi i Agjensise

(.....)

VULA

[illegible]

DEKLAROJE QE:

19) listepagesa ka gjithsej _____ punonjes qe paguajne kontribute
dhe _____ punonjes qe paguajne tatim mbi te ardhurat nga punesimi
PERFAQSUESI I Personit Juridik/Fizik

Emri, mbiemri, firma, juridiku edhe vula

VERTETOJ qe:

Inspektori i Deges Tatimeve marrës në dorezim
() dhe ka gjithsej _____ faqe
Listepagesat gjithsej mbillet me nr. rend. _____ dhe ka gjithsej _____ faqe
Listepagesa u muar në dorezim në Degen Tatimeve në datën _____

Emri Atesia Mbiemri _____

Datelindja _____

Vendlindja _____

Numri personal i regjistrit _____

Numri personal i indeksit _____

Numri i sigurimit _____

[illegible]

DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQERORE _____
AGJENSIA _____

_____ më _____

VERTETIM

(Per te vetepunesuarit ne bujqesi)

Me të cilin vërtetojmë se z. _____
emri atësia mbiemri

është banor i komunës _____ i fshatit _____

ka tokë në pronësi, përdorim që nga viti _____ figuron i siguruar si i

vetëpunësuar në bujqësi që nga viti _____ në rregjistrin e të vetëpunësuarve

në bujqësi me nr. _____. Nr. i librezës së sigurimit _____.
Kontributet e derdhura sipa viteve janë:

Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:
Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:
Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:
Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:
Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:
Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:
Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:
Viti _____ me m.a nr. _____, date _____; Viti _____ me m.a nr. _____, date _____:
Periudha nga _____ deri _____; Periudha nga _____ deri _____:

Lëshohet për efekt përfitimi nga Ligji i Sigurimeve Shoqerore

INSPEKTORI I KONTRIBUTEVE

PERGJEGJESI I AGJENSISE

DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQERORE _____

_____ më _____

V E R T E T I M

(Të vetëpunësuarat për barrë lindje)

Me të cilin vërtetojmë se Znj/ _____ me Nr. Sigurimi
_____ me profesion _____ është siguruar për periudhën
prej _____ deri më _____ deklarimin e datës
_____ sipas rregjistrimit Nr. _____ deklarimin e datës
_____ sipas rregjistrimit Nr. _____

(_____)
(atësia për profesionin që ushtron)

Derdhjet e kontributeve janë bërë si më poshtë, për periudhën e fundit të sigurimit:

3 / Mujori i I _____ Dt. _____ Nr. Mandatit _____

3 / Mujori i II _____ Dt. _____ Nr. Mandatit _____

3 / Mujori i III _____ Dt. _____ Nr. Mandatit _____

3 / Mujori i IV _____ Dt. _____ Nr. Mandatit _____

Lëshohet për efekt përfitimi nga ligji i Sigurimeve Shoqërore.

ARKIVISTI

K/ Degës së Kontributeve

D R E J T O R I

Mjeku i Sigurimeve Shoqërore **VULA**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ / _____ / _____

VERTETIM

Vërtetohet se subjekti _____ ka derdhur në rregull
Kontributin e Sigurimeve Shoqërore, sipas Ligjit në fuqi për
periudhën _____ për Z/Znj _____
Lëshohet ky vërtetim për përdorimet e lejuara nga ligji në fuqi dhe për nevojat e
të interesuarit.

INSPEKTORIE
(_____)

DREJTORI
(_____)

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ / _____ / _____

VERTETIM

Vërtetohet se subjekti _____ ka derdhur në rregull
Kontributin e Sigurimeve Shoqërore, sipas Ligjit në fuqi për
periudhën _____ për Z/Znj _____
Lëshohet ky vërtetim për përdorimet e lejuara nga ligji në fuqi dhe për nevojat e
të interesuarit.

INSPEKTORIE
(_____)

DREJTORI
(_____)

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar pranë:

- njërive postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,

pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"

Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim,2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
8.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
9.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim,2005)	500
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 31.10.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë